



UNIVERSITETI - UNIVERSITY - UNIVERZITET
"HAXHI ZEKA"

SYLLABUSI I LËNDES: FINANCAT DIXHITALE

Të dhëna bazike të lëndës	
Njësia akademike:	Fakulteti i Biznesit
Titulli i lëndës:	Financat dixhitale
Niveli:	Master
Status i lëndës:	Obligative
Viti i studimeve:	I
Numri i orëve në javë:	3+0
Vlera në kredi – ECTS:	6
Koha / lokacioni:	
Mësimdhënësi i lëndës:	Prof. Ass. Dr. Vjosa Hajdari
Detajet kontaktuese:	Mimoza.luta@unhz.eu
Përshkrimi i lëndës	"Financat Dixhitale" është një kurs i avancuar që hulumton ndërveprimin midis teknologjisë dixhitale dhe sistemeve financiare. Kjo lëndë fokusohet në konceptet dhe aplikimet e financave dixhitale, duke përfshirë teknologjitë si blockchain, kriptovalutat, dhe aplikacionet e pagesave dixhitale. Studentët do të analizojnë impaktin e këtyre teknologjive në sektorin financiar dhe do të shqyrtojnë rreziqet dhe avantazhet e tyre. Gjithashtu, do të trajtohet tema si siguria e informacionit financiar, rregullimi i industrisë së financave dixhitale, dhe zhvillimet e fundit në këtë fushë. Kursi synon të përgatisë studentët për të kuptuar dhe për të menaxhuar më mirë financat dixhitale në kontekstin e biznesit modern.
Qëllimet e lëndës:	Qëllimi i lëndës "Financat Dixhitale" është të ofrojë studentëve njohuri të thella mbi konceptet dhe teknologjitë që përdoren në financat dixhitale, duke përfshirë blockchain-in, kriptovalutat, dhe aplikacionet e pagesave dixhitale. Kjo lëndë synon të përgatisë studentët për të kuptuar, analizuar, dhe menaxhuar efektet e teknologjisë në sektorin financiar dhe tregtinë dixhitale, duke iu lejuar ata të zhvillojnë strategji inovative për përdorimin e teknologjisë në financë.

Rezultatet e pritura të nxënies:	Pas përfundimit të këtij kursi, studentët duhet të jenë në gjendje të: • Kuptimi i teknologjive: Studentët pritet të kenë një kuptim të thellë të teknologjive dixhitale si blockchain dhe kriptovalutat dhe se si ato ndryshojnë paradigmat e financave tradicionale. • Analiza e impaktit: Të jenë në gjendje të analizojnë impaktin e teknologjisë në sektorin financiar dhe në tregtinë dixhitale, duke identifikuar avantazhet dhe rreziqet potenciale. • Zhvillimi i strategjive: Të zhvillojnë aftësitë për të hartuar strategji dhe aplikime të financave dixhitale në kontekstin e biznesit modern, duke përfshirë inovacionin dhe strategjitë e suksesit.		
Kontributi në ngarkesën e studentit (gjë që duhet të korrespondoj me rezultatet e të nxënit të studentit)			
Aktiviteti	Orë	Ditë/javë	Gjithësej
Ligjerata	3	15	45
Ushtrime teorike/laboratorike	0	15	0
Kontaktet me mësimdhënësin/konsultimet	1	10	10
Ushtrime në teren	2	10	20
Seminare, projekte, prezentimet,etj.	20	1	20
Koha e studimit vetanak të studentit	2	15	30
Koha e kaluar në vlerësim (teste, kuiz, provim final)	10	1	10
Përgaditja përfundimtare për provim	5	3	15
Totali			150

Metodologjia e mësimdhënies:	Mësimdhënia do të zhvillohet përmes ligjëratisë, detyrave praktike, interpretimeve individuale e grupore, punimit hulumtues, vetëvlerësimeve periodike, etj. Prezantimi i temës mësimore në Power Point. Përsëritja e temës paraprahe nga grupi i caktuar i studentëve, analiza dhe diskutime. Në aspektin teorik do të ofrohen njohuri të përgjithshme shkencore, bazuar në literaturën bashkëkohore. Pjesa praktike kryesisht do të realizohet përmes shembujve konkret nga literatura dhe nga njohuritë praktike të ndërmarrjet prodhuese private e publike dhe të organizatave jofitimprurëse.
Metodat e vlerësimit:	• Testi i parë vlerësues: 0 - 20% • Testi i dytë vlerësues: 0 - 20% • Punimi shkencor: 0 - 50% • Interaktiviteti, detyrat e shtëpisë dhe angazhimet tjera 0 – 10% ose • Provimi përfundimtar: 0 - 50%
Literatura	
Literatura bazë:	▪ Hines, Baxter, Digital Finance: Security Tokens and Unlocking the Real Potential of Blockchain Hardcover – December 3, 2020
Literatura shtesë:	▪ Voshmgir, Shermin, Token Economy: How the Web3 reinvents the Internet (Token Economy: How the Web3 reinvents the internet (English original & foreign language translations)) Second Edition ▪ Completing The Enigma: Should Balkan Countries Be Part Of The Eurozone, Publication Journal of the Danube University. Economic Publication date 2020/9/3, Volume 16, Number 5
Plani i dizajnuar i mësimi:	
Java	Ligjerata që do të zhvillohet
Java e parë:	Hyrje në lëndë dhe njohimi me planprogramin
Java e dytë:	Hyrje në Financat Dixhitale
Java e tretë:	Teknologjitë Kryesore në Financat Dixhitale
Java e katërt:	Impakti i Financave Dixhitale në Sistemin Financiar
Java e pestë:	Rreziqet dhe Avantazhet e Financave Dixhitale

Java e gjashtë:	Testi i parë
Java e shtatë:	Financat Dixhitale dhe Strategjitë e Biznesit
Java e tetë:	Studime Rasti në Financat Dixhitale
Java e nëntë:	Zhvillimet e Fundit dhe Tendencat në Financat Dixhitale
Java e dhjetë	E vërteta diçka e çuditshme për Bitcoinin
Java e njëmbëdhjetë:	Buxheti i teknologjisë dhe financa digitale
Java e dymbëdhjetë :	Siguria e informacionit dhe rreziket në financat dixhitale
Java e trembëdhjetë:	Blockchain dhe tregtia e kriptovalutave
Java e katërbëdhjetë:	Rregullimi dhe ligjet në financat dixhitale
Java e pesëmbëdhjetë:	Testi i Dytë

Politikat akademike dhe rregullat e mirësjelljes:

Cakto politikat e mirësjelljes konform statusit të UHZ-së.

- Para së gjithash, studenti duhet të jetë i ndërgjegjshëm dhe të respektojë institucionin dhe rregullat shkollore;
- Duhet të respektojë orarin e ligjëratave, ushtrimeve dhe të jetë i vëmendshëm në orën mësimore;
- Është i obliguar posedimi dhe paraqitja e indeksit dhe mjetit të identifikimit në teste dhe provim;
- Gjatë hartimit të punimeve seminarike, studenti duhet të përmbahet udhëzimeve të dhëna nga mësimdhënësi për realizimin hulumtues dhe teknik të punimit;
- Testet dhe provimet vlerësohen individualisht për secilin student. Prandaj, studentet duhet të përqëndrohen vetëm në njohuritë personale.
- Shkelja eventuale e këtyre parimeve etike (rregullave) ndëshkohet konform normave të parapara me ligj.